Projekti REBUS

Projekti është i financuar nga programi për zhvillimin e kapaciteteve në arsimin e lartë, Erasmus +, nga Komisioni Europian. Projekti REBUS (Ready for Business) ka si qellim: Studentët tanë, të cilët do të jenë në gjendje të shkëmbejnë ide të ndryshme me studentët e universiteteve të tjera të cilat janë pjesëmarrës në këtë projekt. Ide te ndryshme inovative për realizimin e projekteve të tyre; Ide praktike dhe inovative, ku ndërlidhja me fushën e teknologjisë informative do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e ideve ndërmarrëse dhe krijimin e vendeve të reja të punës në Kosovë; Përkrahja e studenteve dhe profesorëve nga projekti REBUS: Përkrahja me platformën Mahara, e cila ndihmon të ndërlidhë profesorët dhe studentët tanë me universitet tjera; Përkrahja e profesorëve dhe e studentëve që të trajnohen në Graz të Austrisë për një periudhë të caktuar. Pastaj këto njohuri studentët dhe profesorët pjesëmarrës ti shpërndajnë në universitetin tonë. Studentët e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan përfitues të programit për zhvillimin e shkathtësive ndërmarrëse nga projekti REBUS (REady for BUSiness), të financuar nga Erasmus + të Komisionit Evropian, nga 15 shtator deri më 1 tetor të vitit 2018 kanë qëndruar në Universitetin e Shkencave Aplikative Joanneum në Graz të Austrisë, ku pos tjerash në aktivitete të shumta, ata po kanë qenë pjesë e trajnimit për zhvillim të moduleve inovative, moduleve trajnuese nga ndërmarrësia dhe validimi i kompetencave, përmes të cilave, pjesëmarrësit kanë pasur mundësi t'i shohin kërkesat dhe nevojat e tregut të punës.